



UNIVERSITETI "KADRI ZEKA" UNIVERSITY

Adresa Rr. Zija Shemsiu pn, 60000 Gjilan, Republika e Kosovës

www.uni-gjilan.net

Ref.nr. 02/2697/16/12/2019

Këshilli Drejtues i UKZ-së në Gjilan
Kryesuesi i KD-së: MSc. Ibrahim Kosumi

Reagim me shkas:

Pas Ri-rangimit të radhës të Universiteteve dhe të Kolegjeve të Republikës së Kosovës.

Rangimi i Universiteteve në web metric do të ishte krejt në rregull (edhe pse ka vend për përmirësim) mirëpo çka nuk është në rregull është fakti se Universitetet Publike dhe Kolegjet në Republikën e Kosovës janë paraqitur sërish nën flamurin e huaj nën atë të Serbisë !!!

Po ashtu interesant është fakti se rangimi i Universitetit të Prishtinës i cili vepron në Mitrovicë të Veriut në gjuhën serbe, i bie të jetë i dyti në Kosovë bazuar në rangimin sipas kualitetit gjë që nuk kemi koment.(për më tepër shih shpjegimin e algoritmit të rangimit në):

http://www.webometrics.info/en/current_edition

Kërkojmë

Reagim zyrtar nga MASHT-ti dhe MPJ ndaj këtij asociacioni ndërkombëtar që për vite me radhë po e bënë të njëjtin gabim duke na radhitur nën flamurin e një shteti që nuk i takojmë tash e njëzet vite, pra që nga 12.Qershori .1999 kur Kosova është çliruar nga ky shtet. Tani shteti ynë pra Republika e Kosovës ka Flamurin dhe Stemën e vet me të cilat simbole e kanë njohur mbi 100 shtete të botës.

Lusim ministrin Z. Shyqëri Bytyqi – ministër në MASHT që përmes ministrit z. Bexhet Pacolli –MPJ të reagoj pranë këtij asociacioni ndërkombëtar që të përmirësoj gabimin dhe në të ardhmen të mos kemi këso lloj lëshimesh të natyrës politike, konsiderojmë se politika nuk ka vend në institucione edukative arsimore.



Kryesuesi i KD-së
MSc.Ibrahim Kosumi